



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada - Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
**Kabineti i Ministrit të Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice**

Nr. 01.085/2020  
Datë: 14 . 12 .2020

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (GZ nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 58 (paragrafi 6) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, si dhe në pajtim me nenin 8 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (19.02.2020), e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2020, Ministri i Drejtësisë nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Caktohet Komisioni për pranimin e dokumenteve, shënimeve, librave, vulave dhe gjësendeve të depozituara në Zyrën e Noterit Naim (Selim) Rrecaj në Komunën e Obiliqit dhe dorëzimin e tyre në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në këtë përbërje:

- 1.1. Erdon Gjinolli, Udhëheqës i Shërbimit Administrativ në Odën e Noterëve, Kryesues;
- 1.2. Admir Sadiku, Zyrtar Ligjorë në MD, anëtar;
- 1.3. Fatmire Morina Osmanaj, Referente e Lartë, anëtar.

2. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi, mban procesverbal për pranim-dorëzimin e dokumenteve, shënimeve, librave, vulave dhe gjësendeve të depozituara.

3. Komisioni fillon punën nga dita e pranimi të këtij vendimi dhe nuk duhet të ketë ndërprerje dhe shkëputje deri në përfundimin e kësaj çështje.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
**Selim Selimi**  
**Ministër i Drejtësisë**

*Vendimi i dërgohet:*

- Anëtarëve të Komisionit;
- Noterit, z. Naim Rrecaj;
- Odës së Noterëve;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.